



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0948

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje të panelistit individual, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr. 0948/2024 dhe ankesa OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr.0952/2024 kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i aparaturave në QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJËS” më 12/12/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e “PRO MEDICAL” SH.P.K.. me nr. 2024/0948 , e datës 04/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i aparaturave në QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike”, me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJËS”, dhe vendimi i AK mbetet në fuqi.
2. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr. 2024/0952, e datës 07/10/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA E PEJËS”, dhe vendimi i AK anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE “PRO MEDICAL” SH.P.K me nr.948/2024 konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

5. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik OE “PRO MEDICAL” SH.P.K me nr.952/2024 Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet si e bazuar , të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 12.12.2023, “KOMUNA E PEJËS” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës Lot 1 43.510.00 Euro dhe Lot 2 9.960.00 Euro.

Me 09.01.2024 AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka shpërblyer me kontratë Lot 1 me kontratë URANIKU-SG SH.P.K dhe per Lot 2 me kontratë Grup i Operatorëve Ekonomik GENIUS KOSOVA SH.P.K.; MADEKOS SH.P.K. ndërsa me 20.09.2024 është bërë raporti i rivlerësimit me të cilin ka shpërblyer të njëjtit OE.

Me 25.09.2024, OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues për të dyja llotet si në dispozitiv të këtij vendimi.

Me 26.09.2024, Autoriteti Kontraktues ka publikuar vendimin përmes të cilit refuzohen si të pa bazuara të dy ankesat e për llot 1 dhe 2 të Operatorit Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues .

Me 04.10.2024, OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0948/2024 ndërsa me datë 07.10.2024 OE “PRO MEDICAL” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0952/2024.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë

mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0948/24 dhe ankesa nr. 0952/24 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0073 i dt:03.04.2024, nr.0427/24 dhe 0435/24 i dt:21/08/2024.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr. 0948/2024 janë parashtruar si në vijim:

AK- KOMUNA E PEJES ne aktivitetin e Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike ky aktivitetet i prokurimit te larteshenuar është bërë në kundërshtim me LPP ku ne më poshtë shtjellojm pretendimet tona, ku edhe jane konfirmuar nga OSHP edhe nëse dorzohet Ankeses në OSHP pësëri nga ne ky rast do të trajtohet konform Rrregullore për prokurimin publik 2022 sipas Neni 67-Vendimi i OSHP citim “67.1 Në përputhje me nenin 105 të LPP-se, rastet e përsëritura me pretendimet të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar me pare, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.rasto do të trajtohet si” .

Gjithashtu mund te theksojm se Vendimi i OSHP me nr. 2024/0073 është aprovuar si e bazuar për OE “Pro Medical” SH.P.K. Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese , por ne kemi vrejtur se nuk jemi trajtuar si barabartë nga AK ku ne vijm do paraqesim fakte dhe shëshmit gjithashtu edhe pretendimet tona anikmore se vlersimi nuk është bërë konfrom LPP

Neni 59. Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlersimit të ofertës të OE te rekomanduar. LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike kundër OE te rekomanduar pra OE”URANIKU-SG SH.P.K”

Pretendimi i pare ankimor. Ne ne DT tek FDT si kriter per LOT 1 si Kerkesa 1 ka qenë si: Kurse OE i rekomanduar në listën e kontratave të dorëzuara nuk ka asnjë kontratë për servisim dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Për kundërt, të gjitha kontratat e nënshkruara përfshijnë shërbime të mirembajtjes dhe kontrolleve periodike të mjediseve përfshirë sistemin e nxemjes qendrore, sistemin e kondicionimit të ajrit, ventilacionin dhe sistemet sanitare.

Është e rëndësishme theksuar se në asnjërin prej tyre nuk përfshihet servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve mjekësore apo stomatologjike. Kjo do të thotë se kontratat aktuale nuk kanë lidhje organike me shërbimet në fushën e pajisjeve mjekësore dhe stomatologjisë. Është vërejtur se

këto kontrata specifike nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti i Kontratave (AK), veçanërisht në lidhje me kërkesën e parë për Lotin 1.

Kjo e bën të pamundur pranimin e tyre nga AK sepse ky OE nuk ka kryer shërbime në fushën e pajisjeve mjekësore dhe stomatologjisë për të plotësuar kërkesat e përcaktuara nga AK, por këto janë kontrata dhe punë sanitare dhe ndertimatarsie pra nje kontrate.

Disa nga provat jane te listuar me poshte ju lutem shikoni me poshte apo referencat.

Por vërehet qartë se ak, në çdo rast, dëshiron të rekomandojë një oe për kontratë, edhe pse nuk ka përmbushur kriteret e dt. kjo do të ishte e njëjtë sikur një oe që merret me servisim të automjeteve të rekomandohej për kontratë për servisim të pajisjeve mjekësore stomatologjike, ne kemi vënë re sa komisioni vlersueses nuk ka bërë vlersim konfrom lpp neni 59 dhe dt.

Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 1 është ne kundërshtime me Neni 59.4 citim "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik 40.2 citim " Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve"

Edhe 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Pra siq kemi cekur me lart dhe ne bazë LPP Neni 59.4 , Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhezues Nr-001 2023 per prokurimin publik ky OE duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontrata.

Pretendimi i dyte anikomore. Operatori ekonomik i rekomanduar per kontrate eshte OE i pa pergjegjeshem pasi qe ka ofertuar me çmime jo nomrlisht te uleta, neve habitemi ne AK-ne pse nuk kane vepruar konfor legjislacionitne fuqi. Sipas Rregullores Nr.001_2022 per prokurimin publik konkretisht neni 41 Tenderet Jo-normalisht te Ulet, neni 41.4 thuhet: " Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë

dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së.

AK do të veprojë në përputhje me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurimin Publik. Shihet qartë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë dhe OE tjere kanë ofertuar me çmime manipuluese pra janë me çmim jo normalisht e ulet është dashur menjëher ta eliminojë këtë operator ekonomik e jo ta shpërblejë me kontratë apo si OE të përgjeshëm.

Për çmimi, edhe pse NJK ka njohuri rreth çmimeve të tregut për këtë shërbim, nuk ka ngritur asnjë shqetësim në lidhje me këtë.

Në kemi bashkëngjitur parametrimin dhe analizimin e çmimeve të OE të rekomanduar për disa pozicione ku kemi afruar anaizim, fakte dhe prova se çmimet janë manipuluese.

Shikoni çmimet për pozicionet 35,36,37 dhe 38 si kemi listuar edhe pozicionet tjera janë çmime manipuluese në pjesë rrezervepor si ka mundësi pozicioni 35 si Denontimi i karrikes, transport dhe zhvendosja në vend tjetër të bëhet vetëm me 2 euro çmimin me TVSh ose neto pas tatimit 1.53 cent kurse një karrike ka mbi 230kg duhet min 3 persona vetëm për transportuar pra ngarkuar dhe zhgarkuar plus shërbimet tjera.

Pozicioni 36 Montim, aktivizimi dhe ndërimi i të gjitha elementeve dhe garancioni për muaj vetëm me 2 euro ose 1.53 cent me çmimin neto pas tatimit, gjithashtu 37 mbështja e karrikes me lekura vetëm 5 euro ose pozicioni 38 Servisim paketuesi vetëm me 1 euro ose neto 0.76 cent pra anomali me çmime pra enroma të ulta që bie ndesh me RrPP pra Neni 41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë: a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

AK duhet të ketë parasysh Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik pra Neni si: 41.9 Përveç elementeve të tenderit të përcaktuara në nenin 41.8 të kësaj rregullore, Autoriteti kontraktues duhet të marrë në konsideratë:

a. elementet e tenderit përfshirë elementet e nën-totaleve për paga si dhe kompensimet, materialet, kostot fikse dhe profitet.

Sektori i Stomatologjisë ka informacion se ka kushtoj këto shërbime si montimi, demonetimi dhe pjesë rrezerve sepse ata marrin këto shërbime edhe në sektorin privat ku këto çmime janë nën çmimin e tregut pra janë enroma të ulta, ju lutem analizoni çmimet edhe njëherë të OE të rekomanduar sepse besojmë se komisioni ka anomali dhe AK dhe nuk e dërgoni as raportin e vlerësimit edhe pse kemi kërkuar..

Oferta e OE të rekomanduar për kontratë është jo-normalisht e ulët në krahasim me objektin e kontratës dhe AK ka qenë obliguar në përputhje me nenin 41.6 të Rregullores së prokurimit publik, të kërkojmë nga ju të jepni një shpjegim detaj të elementeve përbërëse të tenderit, pra një zbatim të detajuar të pozicioneve të cekura më lartë e jo të kërkojnë vetëm një DEKLARATË siç

pretendon AK dhe e përmbush apo mund të pranohet nga AK sepse LPP dhe Rregullores së prokurimit publik Neni 41.6 dhe 41.9 jep sqarime të sakta se duhet AK të veprojnë në këto raste.

Disa analiza të parmasës si: Shumë pozicione të tjera janë me çmime të paarsyeshme dhe manipuluese. Ja disa nga pozicionet e përmendura më lart për shërbimet e më poshtme.

Ne, si Operator Ekonomik (OE), kemi njohuri të detajuara për çmimin e pjesëve për karrika stomatologjike dhe pajisje të tjera stomatologjike, pasi jemi importues të pjesëve rezervë për karrika stomatologjike. Çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar NUK janë në përputhje me çmimet e tregut dhe nuk është e mundur të blihen pjesët për karrika stomatologjike me këto çmime. Shihni foton e materialit të pjesëve rezervë për karrika stomatologjike që kemi në stok.

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, OE "PRO MEDICAL" SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 59, dhe 72 të LPP-së si dhe Rregullore për prokurimin publik 2022 Neni 40. AK ne vend që ta eliminojë këtë OE nga ky aktivitet i prokurimit, AK e ka shpërblyer me kontratë kundersligjeshme pasi që sipas sqarimeve të mesiperme, plotësohen të gjitha kushtet ligjore për ta eliminuar. VENDIMI të APROVOHET si e bazuar kërkesa për rishqyrtim dhe lenda të kthehet në RIVLERESIM, dhe gjatë fazës së rivleresimit AK të marrë parasysh LPP për LOT 1.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim për OE "PRO MEDICAL" SH.P.K., Operatori Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. me datën 20.09.2024, ka parashtruar kërkesën për Ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Servisimi i aparatave në QKMF LOT

1- Servisimi i aparatave stomatologjike me Nr. të Prok: 635-23-13870-2-2-1 nr i 635-23-111-221 nxjerr:

Autoriteti Kontraktues, me datën 26.09.2024 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

A.K pas analizës së kërkesës së juaj për Ri-shqyrtim duke marrë për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 25.09.2024, e ka trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka arritur në përfundim se njejtë është e pa bazuar.,

Përgjegjja nga A,K 1, Në emër të Autoritetit Kontraktues (AK) dhe Komisionit Ri Vlersues, ju njoftojmë se kemi vepruar sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Rregullores Nr. 001/2022. Pas shqyrtimit të ankesës së OE URANIKU, kemi konstatuar se ajo ishte pjesërisht e bazuar.

Sipas Neneve 72 dhe 59 (1) të LPP-së, kemi kërkuar sqarime shtesë për ofertat e paraqitura. Me datë 12.09.2024, iu dërguam një letër standarde për kërkesën e sqarimeve për OE URANIKU SG. Në përgjigje, OE dorëzoi sqarimet e nevojshme më datë 16.09.2024. Komisioni Ri-vlersues e shqyrtoi dhe miratoi këto sqarime, duke përfshirë pretendimet ankimore.

Pas kësaj rivlerësimi, ne si AK konkludojmë se pretendimet ankimore të OE PRO MEDICAL SH.P.K janë të pabazuara dhe kemi vepruar në përputhje me LPP-në. Po ashtu po ua përciellim edhe sqarimet e bera dhe pergjigjet nga OE i propozuar per kontrat

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr.0952/2024 janë parashtruar si në vijim:

AK- KOMUNA E PEJES ne aktivitetin e Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike ky aktivitetet i prokurimit te larteshenuar është bërë në kundërshtim me LPP sipas Neni 67-Vendimi i OSHP citim “67.1 Në përputhje me nenin 105 të LPP-se, rastet e përsëritura me pretendimet të njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar me pare, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar “res judicata”.rasto do të trajtohet si” .

Gjithashtu mund te theksojm se Vendimi i OSHP me nr. 2024/0073 është aprovuar si e bazuar për OE “Pro Medical” SH.P.K. Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi- Ky nene është parimi bazë i Prokurimit Publik, ku cekë se Autoriteti kontraktues duhet ti trajtojë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese , por ne kemi vrejtur se nuk jemi trajtuar si barabartë nga AK ku ne vijm do paraqesim fakte dhe shëshmit gjithashtu edhe pretendimet tona anikmore se vlersimi nuk është bërë konfrom LPP

Neni 59. Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve- AK nuk ka respektuar LPP gjatë vlersimit të ofertës të OE te rekomanduar. LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike kundër OE te rekomanduar pra GOE” " GENIUS KOSOVA " SH.P.K. dhe MADEKOS” ku ne më poshtë shtjellojm pretendimet tona, ku edhe jane konfirmuar nga OSHP, pra ne besoj se kjo Ankese në OSHP pësëri nga ne ky rast do të trajtohet konform Rrregullore për prokurimin publik 2022

Pretendimi i pare ankimor. Në DT tek FDT si kriter per LOT 2 si Kërkesa 1 ka qenë si: Per (LOT 2) Kërkesa pra Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara. Kurse GOE i rekomanduar në listën e kontratave të dorëzuar, nuk ka asnjë kontratë për shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Të gjitha kontratat janë për furnizim me materiale mjekësore apo pajisje, pra nuk ka kontrata për shërbime. Ky aktivitet prokurimi është për shërbime, jo për furnizim, dhe këto kontrata nuk mund të pranohet nga AK. Pra, nuk ka asnjë kontratë për shërbimin e pajisjeve mjekësore apo laboratorike, dhe ato nuk kanë lidhje organike me këto shërbime; këto kontrata si të tilla nuk pranohen nga AK..

Ky aktiviteti i prokurimi është për Shërbime në DT AK si kriteri/kërkesa në DT 9.1 & 9.2 për kontrata për Shërbime tek Kapaciteti teknik dhe professional AK vendosin: Per (LOT 2) Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat te natyres se ngjajshme në vler prej 14.900.00 Euro në 3 (tri) vitet e fundit, duke filluar nga data e publikimit të Njofimit për Kontrat. Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara.

Per (LOT 2) Dëshmia 1 Një listë te kontratave të realizuara duke plotësuar, ANEKSIN 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e përfundimit dhe përfituesin si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose procesverbalet për kryerje të shërbimeve.

Pra kemi dy Lloje të kontratave si : 1 Furzimi dhe 2 Shërbime në baze LPP kemi dy lloje të kontratave pra Kontrata për shërbime dhe kontrata për furnizime pra ka dallim në mes tyre, pra shihet qart se ka dallim në mes Furzimi dhe Shërbimeve kur në rastin konkret GEO ka dorëzuar Listen e projekteve jo valid të cilat nuk mund të pranohen nga AK, GOE dorëzon Listen e projekteve për FURNIZIME e jo për

Shërbime pra asnjë kontratë nuk ka për shërbime siç ka cekur AK në Kërkesën 1. Pra, AK e ka saktësuar pra decitivisht termin "kryerje të shërbimeve" në lidhje me (LOT 2) Dëshmia 1. Kjo tregon qartë se ekziston një dallim mes Furzimit dhe Shërbimeve, sidomos në rastin konkret ku GEO ka dorëzuar një listë projektesh që nuk e plotësojnë kërkesën minimale të FDT dhe kanë referenca jo valide, të cilat nuk mund të pranohen nga AK. Në vendimin e AK të datës 14.07.2023, ky GOE është eliminuar me arsyetimin e referencave të cekura më parë.

Megjithatë, në rivlerësim, edhe pse gjendja faktike nuk ka ndryshuar, GOE dorëzon referencat e njëjta për shërbime, por AK e rekomandon për kontratë, në kundërshtim me LPP.

Lista e projekteve nuk mund të ndryshohet ose të dorëzohen referenca të reja nëse ato nuk janë përfshirë në listën e projekteve të dorëzuar gjatë ofertimit. Pra, lista e projekteve nuk mund të modifikohet, siç ka pretenduar OE i rekomanduar gjatë dorëzimit të ankesës në OSHP. Edhe pse në kemi dërguar një shkresë në OSHP si sqarim, besoj se ajo shkresë nuk ka qenë e disponueshme për ekspertin gjatë shqyrtimit dhe trajtimit të asaj ankese, për të cilën kemi bashkëngjitur atë shkresë si dëshmi/informacion për ekspertin shqyrtues.

Provat pra lista e kontratave të Udhëheqësi të GOE ju lutem shikoni më poshtë.

Sa i përket ankesës së OE rekomanduar tani GENIUS KOSOVA për Listën e projekteve dhe referencën e cekur në raportin e ekspertit mund të pranohet si të , kjo nuk qëndron sepse në këtë aktivitet prokurimi në kemi qenë fitues në një LOTO. As në DT dhe as në kontratë tek KVK nuk ka qenë kriter kërkesa për mirëmbajtje 1 vit, siç pretendon OE më poshtë:

Shikoni udhëzuesin e KRPP se si të vepohet. Siç shihet qartë, GOE, në rastin konkret, i rekomanduar për kontratë, nuk ka përmbushur kriteret e vlerësimit. Edhe pse në kemi dërguar një kërkesë tek AK për të pasur qasje në raportin e vlerësimit, nuk e kemi pranuar atë (shihni emailin). Në raportin e vlerësimit janë cekur të gjitha kriteret që përcaktojnë nëse një OE është përgjegjës ose jo, duke plotësuar kriteret në pajtim, si në aspektin administrativ ashtu edhe në atë teknik.

Pra OE i rekomanduar për kontratë për LOT 2 është në kundërshtim me Neni 59.4 citim "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në

fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit” Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik 40.2 citim “ Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”

Edhe 40.6 Tenderi do të konsiderohet i përgjegjshëm kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga Operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Pra siq kemi cekur me lart dhe ne bazë LPP Neni 59.4 , Rregullores 01/2022 per Prokurim Publik 40.2 dhe A02 Udhezues Nr-001 2023 per prokurimin publik duhet të eliminuar nga AK e jo të rekomandohet për kontrata, dhe një herit AK duke e rekomanduar për kontratë ketë OE bie ndesh me Neni 7 të LPP dhe Neni 59.4.

Për informim shtesë dhe për qëllime të saktësisë, po ju përcjellim këtë informacion.

Edhe pse kjo nuk ka qenë në NJK dhe nuk është kriter në DT tek FDT, po e paraqesim si informacion shtesë dhe si një pretendim sekondar ky OE Ginues Kosova nuk ka pasur ISO, ne Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME si kriter ka qenë si:

Lidhur me këtë OE-rekomanduar për certifikatat e ISO standardeve, të njëjtat i ka ofruar vetëm njëri nga anëtarët e grupit, ndërsa si kërkesë duhet të përmbushet nga dy anëtarët e grupit, sqarimin për këtë e gjeni si në vijim sipas Rregullores 01/2022:

Në rast konkret Udhëheqësi i GOE nuk ka ISO cerficate edhe pse është si ekzekutues i kontratës pra në këtë rast AK nuk është i sigurt se shërbimet janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuar në dokumentet e tenderit.

AK e ka vendosur këtë kriter tek Kërkesat e Përshtatshmërisë Profesionale, edhe pse në ankesën e dorëzuar nga OE tani i rekomanduar, është theksuar ky pretendim. Eksperti e ka shqyrtuar këtë pretendim në ankesën me numër 2024/0435, por ai nuk ka qenë pjesë e Kërkesave të Përshtatshmërisë Profesionale. Sidoqoftë, ne kemi dhënë sqarime edhe për ankesën me numër 2024/0435, ku janë përfshirë dëshmi shtesë në këtë ankesë

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, Ankuesi “PRO MEDICAL” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me Neni 1, 7, 59, te LPP-së Rregullores

01/2022 per Prokurim Publik 40. duke propozuar qe te APROVOHET si e bazuar kerkesa per rishqyrtim dhe lenda te kthehet ne RIVLERESIM, dhe gjate fazes se rivleresimit AK te merr parasysh LPP per LOT 2.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim për “PRO MEDICAL” SH.P.K., Operatori Ekonomik PRO MEDICAL SH.P.K. me daten 25.09.2024, ka parashtruar kërkesen për Rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull Prok: Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostikeme Nr. të Prok: 635-23-13870-2-2-1 nr i 635- 23-111-221 nxjerr:

Autoriteti Kontratkues , me datën 26.09.2024 ka shqyrtuar kërkesen në fjalë si më poshtë: A.K pas analizes se kerkeses se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesen tuaj në platformen elektronike të datës: 25.09.2024 ,e ka trajtuar me kujdes kërkesen tuaj, dhe ka ardhur ne perfundim se njejta eshte e pa bazuar.

Pretendimet e O,E 1 Per (LOT 2) Kërkesa pra Në rast të grupit Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuara në 3 vitet e shkuara.

Kurse GOE i rekomanduar në listën e kontratave të dorëzuar, nuk ka asnjë kontratë për shërbimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve mjekësore. Të gjitha kontratat janë për furnizim me materiale.

mjekësore apo pajisje, pra nuk ka kontrata për shërbime. Ky aktivitet prokurimi është për shërbime, jo për furnizim, dhe këto kontrata nuk mund të pranohet nga AK. Pra, nuk ka asnjë kontratë për shërbimin e pajisjeve mjekësore apo laboratorike, dhe ato nuk kanë lidhje organike me këto shërbime; këto kontrata si të tilla nuk pranohen nga AK..

Pergjegjia nga A,K 1, Ju njoftojm se ne si A,K dhe Komisioni Ri-Vlersues ju njofton se ka vepruar konform vendimit te OSHP-se ku kemi kemi kerkuar sqarime lidhur me referencat per punet e perfunduara pasi qe OE i propozuar per kontrat ka kontrata te natyres se ngjajeshme furnizime, dhe sherbime per mbrenda kontratave te prezantuara nga vete OE andaj ne kemi zbatuar vendimin e OSHP-se ku kemi kerkuar sqarime per kontratat e ofruar nga GRUPI I OE andaj ne si AK dhe komisioni ri vlersues ju njofton se pretendimet e juaja per ket pike jan te pa bazuara

Pretendimet e OE 2 Pretendimi i dytë ankimor Ne Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME si kriter ka qenë si: Sipas INTERPRETIME te KRPP e dates 22.06.2023 citim “ Si rrjedhojë, kurdo që AK kërkon certifikata që vërtetojnë cilësinë e menaxhimit të kompanisë, për shembull Certifikata ISO 9001..., secili anëtar i grupit duhet të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë. Një certifikatë e tillë mund të kërkohe në rast të kontratave për shërbime kur të gjithë anëtarët e grupit do të angazhohen në ofrimin e shërbimit”

Pergjegjia nga AK 2, Dëshirojmë tju informojmë se O.E. i propozuar për kontratë është në përputhje me dokumentacionin e kërkuar, siç parashikohet në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe në dokumentet e tenderit. Sipas interpretimit të Komisionit Rregullator të Prokurimeve Publike (KRPP) të datës 22.06.2023, është e qartë se çdo anëtar i grupit të konzorciumit duhet të posedojë certifikatat për cilësinë e menaxhimit kur kërkohet një certifikatë e tillë, si për shembull ISO 9001. Megjithatë, nëse në dosjen e tenderit janë parashikuar certifikatat ISO në aneksin përkatës, kërkesat për përshtatshmërinë profesionale janë të natyrshme.

Për LOT 2, O.E. obligohet të dorëzojë:

Certifikatat ISO 9001:2018 dhe ISO 13485:2018. Një certifikatë servisi për të paktën njërin nga pajisjet për të cilat kërkohet servis (Selectra ProM ose Mindray). Kështu, ndonëse certifikatat duhet të jenë të pranishme, ato mund të dorëzohen nga njëri nga anëtarët e grupit të konzorciumit, jo domosdoshmërisht nga secili anëtar veç e veç, siç është sqaruar nga interpretimi i KRPP-së.

Prandaj, me keqardhje ju njoftojmë se pretendimet tuaja ankimore në këtë pikë janë të pabazuara.

Po ashtu ju si OE nuk plotësoni kriterin e kerkua ne specifikacionin teknik ku kerkohet si ne vijim

OE duhet te posedoj 1 Certificate servisi per te pakten njeren nga paisjet per te cilat kerkohet servis Selectra ProM ose Mindray.. Ju ne oferten e juaj keni dorzuar personin e certifikuar per servisim Z.Nazmi Lohaj i cili eshte certifikuar ne kompanin GENIUS KOSOVA SH.P.K, e jo ne kompanin e juaj PROMEDICAL.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 08.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0948/2024 ndërsa me datë 10.10.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0952/2024.

Lidhur me ankesën nr. 0948/24 me datë 21.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me nr. 2024/0948 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertin shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Lidhur me ankesën nr. 0952/24 me datë 21.10.2024 është dorëzuar raporti i ekspertës shqyrtuese me Nr. 2024/0952 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertin shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës me nr.0948/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk pajtohet rreth raportit

te ekspertit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës me nr.0952/24 e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes shqyrtuese, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesve, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “PRO MEDICAL” SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0948 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike" me nr. të prokurimit: "635-23-13870-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, procedurë të hapur, lloji i kontratës Shërbim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Sqarojmë se, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit për LOT 1 dhe LOT 2 gjenden dy vendime të panelit shqyrtues për dy lotët: 0073/2024 dt. i dt:03.04.2024, nr.0427/2024 dhe 0435/2024 i dt:21/08/2024, nga të cilat, fillimisht vendimi i panelit shqyrtues me nr. 0073/2024 ka kthyer lëndën në rivlerësim, në mënyrë që të sqarohen dokumentet konform nenit 72 të ligjit për prokurim publik sipas pretendimeve të ngritura të OE ankues. Mirëpo AK nuk ka rivlerësuar ofertat konform rekomandimeve të dhëna, por, vetëm ka ndërruar operatorët ekonomik pa sqaruar dokumentet sipas rekomandimit. Dhe si e tillë, pas rivlerësimit lënda prap kthehet në OSHP, të cilët parashtrajnë pretendime ankimore kundër vendimit të AK-së, i cili nuk kishte respektuar rekomandimet sipas vendimit 0073/2024, dhe si pasojë e kësaj shtate, paneli shqyrtues merr vendim me nr.0427/2024 dhe 0435/2024, që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, për faktin se, nuk janë rivlerësuar ofertat konform LPP-se.

Tani, duke qenë se, rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit ka ndërruar operatorët ekonomik të rekomanduar, si e tillë OE ankues shpallet i pasuksesshëm.

Pretendimi i parë i OE ankues:Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues, në raportin 0073/2024 kam rekomanduar që në rivlerësim të kërkoj sqarime lidhur me këto projekte të përfunduara, dhe si e tillë, AK në rivlerësim nuk ka kërkuar sqarime, dhe rrjedhimisht, lënda me vendim të PSH. 0427/2024 dhe 0435/2024 është kthyer prap në rivlerësim. Gjerësa, në rivlerësim pas vendimit të fundit të panelit shqyrtues, AK kërkon sqarime shtesë (kontratat për të njëjtat projekte të potencuar në listën e ofruar në ofertë) nga OE Uraniku-SG, lidhur me projektet e përfunduara, dhe si e tillë OE në fjalë ka bashkangjitur kontrata e lidhura për të njëjtat projekte, të cilat janë instalim, servisim dhe mirëmbajtje shumica e tyre, andaj sipas raportit me nr. 073/24, kam rekomanduar që AK të sqarohet edhe më njësinë

kërkuese se nëse mund të merren të mirëqenë këto projekte, me qëllim që të vërtetohet përvoja e OE të rekomanduar dhe në mënyrë që të respektohet neni 1, 6 i LPP-së, andaj si e tillë konsideroj se merren të mirëqenë projektet sipas komisionit profesional të vlerësimit.

Raporti i kaluar: 0073/2024

Pretendimi i dytë i OE ankues:Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues sqaron se, AK pas vendimit të PSH. Nr. 427/24 dhe 435/24, sipas rekomandimit në vendimin paraprak nr.0073/2024, kërkon sqarime shtesë lidhur me çmimet e ofruara, dhe si e tillë, OE Uraniku -SG SHPK ka sqaruar se qëndrojnë prapa çmimeve të ofruara, dhe rrjedhimisht mbetet në diskrecion të AK-së mirëqenia e sqarimeve lidhur me sqarimet e dhëna nga OE në fjalë, sipas dispozitës ligjore 41 paragrafi 10 i RRPP-së nr.001/2022.

Raporti 0073/2024

Vendimi i panelit shqyrtues 0073/2024:

Si përfundim, aktiviteti i prokurimit i iniciuar nga AK-Komuna e Pejës, është zvarritur si pasojë e mos respektimit të vendimit të panelit shqyrtues me nr.0073/2024, sipas të cilit, AK është dashur që të vlerësoj ofertat konform rekomandimeve duke u bazuar në ligjin e prokurimit publik, rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, si dhe udhëzuesi për prokurim publik nr.001/2023, me qëllim që të përmbyllë procesin e vlerësimit në mënyrë profesionale. Dhe si e tillë, sipas sqarimeve më lartë, rekomandoj që aktiviteti i prokurimit për LOT 1 të mbetet në fuqi vendimi i AK-së, për faktin se vlerësimi i ofertave konform nenit 59.4 të LPP-së mbetet në përgjegjësi të Autoritetit Kontraktues.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues “PRO MEDICAL” SH.P.K., Eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0952 ka vlerësuar se:

Aktiviteti i prokurimit me titull: LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me nr. të prokurimit: "635-23-13870-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PEJES, procedurë të hapur, lloji i kontratës Shërbim, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Sqarojmë se, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit për LOT 1 dhe LOT 2 gjenden dy vendime të panelit shqyrtues për dy lotët: 0073/2024 dt. i dt:03.04.2024, nr.0427/2024 dhe 0435/2024 i dt:21/08/2024, nga të cilat, fillimisht vendimi i panelit shqyrtues me nr. 0073/2024 ka kthyer lëndën në rivlerësim, në mënyrë që të sqarohen dokumentet konform nenit 72 të ligjit për prokurim publik sipas pretendimeve të ngritura të OE ankues. Mirëpo AK nuk ka rivlerësuar ofertat konform rekomandimeve të dhëna, por, vetëm ka ndërruar operatorët ekonomik pa sqaruar dokumentet sipas rekomandimit. Dhe si e tillë, pas rivlerësimit lënda prap kthehet në OSHP, të cilët parashtrajnë pretendime ankimore kundër vendimit të AK-së, i cili nuk kishte respektuar rekomandimet sipas vendimit 0073/2024, dhe si pasojë e kësaj shtate, paneli shqyrtues merr vendim me nr.0427/2024 dhe 0435/2024, që aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim, për faktin se, nuk janë rivlerësuar ofertat konform LPP-se.

Tani, duke qenë se, rivlerësimi i aktivitetit të prokurimit ka ndërruar operatorët ekonomik të rekomanduar, si e tillë OE ankues shpallet i pasuksesshëm.

Pretendimi i parë i OE ankues:Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues kundër GOE të rekomanduar sqaron se, AK pas vendimit të PSH. Nr. 427/24 dhe 435/24, sipas rekomandimit në vendimin paraprak nr.0073/2024, kërkon sqarime shtesë lidhur me kërkesën (Projekte të përfunduara brenda tri viteve), rrjedhimisht në sqarim GOE i rekomanduar bashkëngjit kontratat sipas listës së projekteve, dhe gjithashtu siç pretendon edhe OE ankues i njëjti ka bashkëngjitur kontratat shtesë, të cilat nuk hyjnë në vlerësim për faktin se nuk kanë qenë të cekura në listë të projekteve paraprakisht, mirëpo me dëshmitë e bashkëngjitura, kontratat të cilat janë të përmendura në listë të kontratave, janë të natyrës furnizim, për më tepër edhe në kontratat e bashkëngjitura përcaktohet se kontrata është për furnizim. Andaj konsideroj se nuk e plotëson kërkesën.

Pretendimi i dytë i OE ankues:Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, në ofertën e OE të rekomanduar nuk gjenden ISO standardet për liderin e grupit, andaj konform rregullores për prokurim publik nr.001/2022 neni 26.6 iso standardet duhet që të përmbushën nga secili anëtar i grupit. Si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Si përfundim, aktiviteti i prokurimit i iniciuar nga AK-Komuna e Pejës, është zvarritur si pasojë e mos respektimit të vendimit të panelit shqyrtues me nr.0073/2024, sipas të cilin, AK është dashur që të vlerësoj ofertat konform rekomandimeve, duke u bazuar në ligjin e prokurimit publik, rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, si dhe udhëzuesi për prokurim publik nr.001/2023, me qëllim që të përmbyllë procesin e vlerësimit në mënyrë profesionale. Megjithatë sipas sqarimeve më lartë, bazuar në gjendjen faktike, rekomandoj që ky aktivitet i prokurimit LOT 2, të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrësit e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues pretendimet ankimore të OE“PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr. 2024/0948, i ka shqyrtuar në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional, ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit“Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike”, me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues perms raportit me rekomandim i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“PRO MEDICAL” SH.P.K. dhe vrehet se pretendimet ankimore janë vlersuar si te pabazuara. Paneli Shqyrtues lidhur me vlersimin e pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, i mbeshtet vlersimet e raportit të ekspertit shqyrtues dhe në këtë mënyrë është gjetur se ankesa e operatorit ekonomik ankues OE“PRO MEDICAL” SH.P.K, është e pa bazuar. Andaj paneli shqyrtues ka vendosur qe te mbetet ne fuqi vendimi i AK per dhenie te kontrates, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Servisimi i aparaturave ne QKMF LOT 1- Servisimi i aparaturave stomatologjike”, me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1.

Paneli shqyrtues pretendimet ankimore të OE“PRO MEDICAL” SH.P.K., me nr. 2024/0952, i ka shqyrtuar në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional, ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit “LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike”me numër të prokurimit 635-23-13870-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues perms raportit me rekomandim i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“PRO MEDICAL” SH.P.K. dhe vrehet se pretendimet ankimore janë vlersuar si te bazuara. Paneli Shqyrtues lidhur me vlersimin e pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, i mbeshtet vlersimet e raportit të ekspertit shqyrtues dhe në këtë mënyrë është gjetur se ankesa e operatorit ekonomik ankues OE“PRO MEDICAL” SH.P.K, është e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me “LOT 2- Servisimi i aparaturave hematologjike diagnostike” me nr. të prokurimit: 635-23-13870-2-2-1, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK –së dhe lënda të kthehet në Rivlersim.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë

profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2024/0948 dhe 2024/0952.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE"PRO MEDICAL" SH.P.K.. me nr. 2024/0948, i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankeses të OE"PRO MEDICAL" SH.P.K.. me nr. 2024/0952, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E PEJES, KOMUNA E PEJES**
- **OE - PRO MEDICAL SH.P.K., PRO MEDICAL SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: